



Prishtinë: 30.09.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1292\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2081\_07\_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **15.09.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 30.09.2020 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.A. nga Komuna e Lipjanit me shifër të konsumatorit DFE - 45000, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2081\_07\_20, i datës 13.07.2020.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 15.09.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit A.A. nga Komuna e Lipjanit lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.43801DFE-45000 të datës 01.11.2016, për këto shkaqe: sipas Departamentit për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, korrigjimi plotësues është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi dhe se konstatimi nga qendra e kalibrimit se njehsori nuk ka bërë matje në fazën e dytë është provë e mjaftueshme që njehsori nuk e ka bërë regjistrimin e shpenzimit të tërësishëm të energjisë elektrike, dhe se çfarëdo analize tjetër duke u bazuar në rrjedhën e energjisë nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje. Po ashtu, nga KESCO theksojnë se konsumatori ka luhatur në shpenzim të energjisë elektrike në periudha të ndryshme kohore, andaj, më meritor është raporti nga qendra e kalibrimit se sa krahasimi i shpenzimeve në periudha të ndryshme.

KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRrE/DMK\_V\_2081\_07\_20, i datës 13.07.2020, për konsumatorin A.A., me shifër DFE – 45000.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO në të cilën pretendohet që analiza e rrjedhës së energjisë elektrike nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje dhe se konstatimi nga qendra e kalibrimit



se njehsori nuk ka bërë matje në fazën e dytë, Bordi i ZRrE-së thekson se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike është një indikacion shumë i rëndësishëm në shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Bordi i ZRRE me qëllim të analizimit sa më të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike, ka bërë krahasimin e shpenzimeve të energjisë të njehsorit elektrik nr.4363477 (njehsori kontestues) dhe njehsorit elektrik nr.67243298 për periudha të ndryshme – tre mujore, gjashtë mujore dhe dymbëdhjetë mujore. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit kontestues për periudhën tremujore 10 – 12/2015 është 777.00 kWh/muaj, ndërsa, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr. 67243298 për periudhën 10-12/2016 është 779.33 kWh/muaj. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr. 4363477 për periudhën 10/2015 – 03/2016 është 703.00 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr.67243298 për periudhën 10/2016 dhe 03/2017 është 694.50 kWh/muaj. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr. 4363477 për periudhën dymbëdhjetë mujore 10/2015 dhe 09/2016 është 711.58 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr. 67243298 për periudhën 10/2016 - 09/2017 është 732.08 kWh/muaj.

Bazuar në krahasimet e bëra, Bordi i ZRrE-së konstaton se, po që se njehsori elektrik nr. 4363477 (njehsori kontestues) nuk do të kishte regjistruar energji elektrike prej 33.33%, atëherë pas rregullimit të saj, respektivisht pas ndërrimit të njehsorit elektrik, ajo sasi e energjisë elektrike do të duhej të regjistrohej në njehsorin e ri, e që rrjedhimisht i bie që konsumatori do të kishte rritje të shpenzimit të energjisë elektrike. Por që në rastin konkret, nuk ka ndodhur diçka e tillë, pasi që konsumatori edhe pas vendosjes së njehsorit të ri me nr. 67243298, ka pasur shpenzime përafërsisht të njëjta si edhe me njehsorin e vjetër.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, si procesverbalet, korrigjimi dhe rrjedha e energjisë elektrike, Bordi i ZRrE-së konstaton se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike tek të dy njehsorët në periudha të ndryshme kohore dhe mbi këtë bazë, Bordi e ZRrE-së e obligon KESCO-n që ta shkarkoj konsumatorin nga korrigjimi shtesë nr.43801DFE-45000 të datës 01.11.2016, në vlerën prej 133.04 EUR, sipas vendimit të organit të shkallës së parë - DMK/ZRrE.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.A. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.